VENDIM
Nr. 784, datë 9.11.2016

PËR MËNYRËN DHE KRITERET E LLOGARITJES SË SHPENZIMEVE TË NDËRHYRJES PËR SHUARJEN E ZJARREVE NË OBJEKTET E SIGURUARA NGA ZJARRI DHE ADMINISTRIMIN E PËRDORIMIN E TË ARDHURAVE, PËR LLOGARI TË SHËRBIMIT VENDOR TË MZSH-SË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 35, ligjit nr. 152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tarifa e ndërhyrjes për shuarjen e zjarreve nga shërbimi i MZSH-së në objektet e siguruara nga zjarri nga shoqëritë e sigurimit është në vlerën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për orë ndërhyrjeje.
2. Për efekt të përllogaritjes së kostove të shërbimit, të ofruar nga shërbimi i MZSH-së në nivel vendor, koha e ndërhyrjes llogaritet nga momenti i daljes së personelit të shërbimit të MZSH-së nga stacioni zjarrfikës dhe përfundon me largimin e tij nga vendi i ngjarjes.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit informon zyrtarisht kryetarët e bashkive për listën e objekteve të siguruara në territorin nën juridiksionin e tyre.
4. Shumat e arkëtuara nga shoqëritë e sigurimit, që kërkojnë ndërhyrje për shuarjen e zjarreve në objektet e siguruara, derdhen në llogaritë e bashkisë përkatëse që ka ofruar shërbimin.
5. Të ardhurat, që krijohen sipas pikës 4, të këtij vendimi, administrohen nga bashkia përkatëse që ka ofruar shërbimin e MZSH-së dhe përdoren për mbulimin e shpenzimeve të kryera, financimin e veprimtarive kryesore, shpenzime operative, rinovim të automjeteve e të pajisjeve zjarrfikëse, për investime dhe shpërblimin e punonjësve të shërbimit vendor të MZSH-së.
6. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe bashkitë përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi